

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
INNVIS SHPK**

Ne Tirane, sot me 31.05.2021, ne të nenshkruarit:

- Znj. Rovena Banaca, shtetase shqiptare, lindur në Berat më 30.08.1979, identifikuar me nr. personal H95830049B;
- Z. Julian Demeti, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan më 27.07.1981, identifikuar me nr. personal I10727126G;
- Z. Erald Buzi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 10.01.1984, identifikuar me nr. personal I40110038M;

permes ketij akti themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe këtë Akt themelimi dhe Statut.

Neni 1  
**Emri dhe Forma**

1.1 Shoqëria do të emërtohet **Innvis** (në vijim "**Shoqëria**").

1.2 Shoqëria Innvis Sh.p.k. krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe ekziston e vepron në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregtare", të ndryshuar (në vijim "**Ligi për Shoqëritë tregtare**") dhe në përputhje me këtë Statut e Akt Themelimi.

Neni 2  
**Selia e regjistruar**

2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: *Rruga Ibrahim Rugova, Nd. 42, H.7, Ap.49, Tirane, Shqiperi.*

2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë celjen e filialeve, selive dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë vendit.

Neni 3  
**Kohëzgjatja e veprimtarisë**


3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë e papërcaktuar.

Neni 4  
**Objekti i veprimtarisë**

4.1 Mbështetur në nenin 7 të ligjit 9901 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare me objekt:

- Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software, duke përfshirë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike.

Testim software, duke përfshirë testimin e funksionaliteteve, të ngarkesës më punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software.

  
1

Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit, duke përfshirë analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/WAN/WLAN/MAN/SAN/CAN).

Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë, duke përfshirë analizën e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse.

Zhvillim sistemesh migrimi, duke përfshirë transferimin e të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re.

Përmirësim/uprade sistemesh informatike;

Disenjim software;s

Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi Teknik/Informatik për sistemet software. Ndërtim, zhvillim dhe operim i qendrave të të dhënave.

- Çdo aktivitet tjetër i lejuar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

4.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet, zgjerohet apo kufizohet përmes vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

#### Neni 5 Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 leke (njqind).

5.1.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 3 kuota me vlerë nominale 45%, 35% dhe 20% secila, respektivisht 45 leke (dyzet e pese), 35 leke (tridhjete e pese) dhe 20 leke (njetet).

#### Neni 6 Kontributet dhe Kuotat e ortakeve

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:


- *Znj. Rovena Banaca, shtetase shqiptare, lindur në Berat më 30.08.1979, identifikuar me nr. personal H95830049B;*
- *Z. Julian Demeti, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan më 27.07.1981, identifikuar me nr. personal I10727126G;*
- *Z. Erald Buzi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 10.01.1984, identifikuar me nr. personal I40110038M;*

- **Znj. Rovena Banaca**, shtetase shqiptare, lindur në Berat më 30.08.1979, identifikuar me nr. personal H95830049B, mbajtëse e një kuote përbërëse e 45% (dyzet e pese) të kapitalit themeltar, me një kontribut prej 45 leke (dyzet e pese);
- **Z. Julian Demeti**, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan më 27.07.1981, identifikuar me nr. personal I10727126G, mbajtës i një kuote përbërëse 35% (tridhjete e pese) të kapitalit themeltar, me një kontribut prej 35 leke (tridhjete e pese);
- **Z. Erald Buzi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 10.01.1984, identifikuar me nr. personal I40110038M, mbajtës i një kuote përbërëse e 20% (njëzet) të kapitalit themeltar, me një kontribut prej 20 leke (njetet).

6.2 E drejta e votës së çdo ortaku është në proporcion me vlerën nominale të kuotës së tij.



2



Neni 7  
**Rritja e kapitalit themeltar**

7.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

7.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë.

Neni 8  
**Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

8.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 9  
**Transferimi i kuotave**

9.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme nëpërmjet shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji. Transferimi *inter vivos* i kuotave drejt të tretëve duhet të jetë subjekt i një të drejte për refuzim fillestar në favor të ortakëve të tjerë të cilët mund ta shfrytëzojnë këtë të drejtë sipas modaliteteve të detajuara në Nenet nga 9.2 deri 9.5 më poshtë.

9.2 Në rast se një ortak ("Ofertuesi") kërkon të shesë dhe/ose transferojë një pjesë ose të gjithë kuotën e tij, ortakët e mbetur ("Ortakët e Mbetur") ruajnë të drejtën për refuzim fillestar në lidhje me kuotën/pjesën që propozohet të transferohet ("Kuota e Ofruar"), subjekt i kërkesave dhe kushteve të mëposhtme:

a) Ofertuesi duhet t'i dërgojë fillimisht Ortakëve të Mbetur një njoftim me shkrim duke detajuar Kuotën e Ofruar së bashku me cmimin, emrin e blerësit dhe kushte të tjera materiale të transfertës ("Oferta"), duke ftuar fillimisht Ortakët e Mbetur të blejnë këtë Kuotë të Ofruar duke shfrytëzuar të drejtën e parablerjes;

b) Në rast se me shumë se një prej Ortakëve të mbetur ka shprehur interes për blerje, ata kanë të drejtë që, në një masë proporcionale me kuotën që zotërojnë, të blejnë Kuotën e Ofruar sipas kushteve të Ofertës duke dërguar një njoftim me shkrim tek Ofertuesi brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh pas marrjes së njoftimit të Ofertuesit.


c) Në rast se Ortakët e Mbetur nuk përgjigjen në afatin e caktuar me sipër, prezumohet se kanë hequr dorë nga ushtrimi i se drejtes se parablerjes.

9.4 Në rast se asnjë prej Ortakëve të Mbetur nuk zgjedh të blejë Kuotën e Ofruar dhe/ose ka refuzuar blerjen, vetëm atëherë Ofertuesi do të ketë të drejtë të transferojë Kuotën e Ofruar tek një palë e tretë, me të njëjtin cmim dhe kushte të Ofertës fillestare.

9.7 E drejta e parablerjejes nuk mund te ushtrohet ne rast te transferimit te kuotave midis ortakeve te Shoqerise.

Neni 10  
**Asambleja e Përgjithshme**

10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

10.3 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga ky Statut dhe Ligji për Shoqëritë Tregtarë si edhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

10.4 Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori/administratorët. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme.

10.6 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të zakonshme e jashtëzakonshme.

#### Neni 11

#### **Kuorumi dhe kompetencat e Asamblese**

11.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet rregullisht dhe mund të marrë vendime të vlefshme me votën pro të 75% (shtatëdhjete e pjese) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur ligji ose ky Statut parashikojnë ndryshe.

11.2 Pa cënuar sa më sipër, në lidhje me çështjet e mëposhtme Asambleja e Përgjithshme mbledhet rregullisht dhe mund të marrë vendime të vlefshme me votën pro unanime të të gjithë ortakëve të Shoqërisë:

- (i) ndryshimi i Statutit;
- (ii) ndryshimi thelbësor i objektit të veprimtarisë së Shoqërisë;
- (iii) emerimi/shkarkimi i administratorit;
- (ii) zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
- (iii) riorganizimi, likuidimi dhe prishja e Shoqërisë ose revokimi i vendimeve në lidhje me veprimet në fjale;
- (v) vendimet për miratimin e dividendeve dhe shpërndarja ose mosshpërndarja e tyre;
- (vii) transferimi i kuotave.

11.3 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikave 11.1 dhe 11.2, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.


11.4 Në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 9901 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për shfuqizimin e ndalimit të konkurrencës për ortakët dhe/ose administratorin/administratorët, të marra sipas kuoromit të përcaktuar në nenin 11.1 të këtij Statuti.

#### Neni 13

#### **Pjesëmarrja, Votimi dhe Përfaqësimi**

13.1 Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.

13.2 Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Handwritten signatures and a stamp. The stamp is a circular official seal with a signature across it. To the right of the stamp is the number '4'.

Neni 14  
**Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme vendos për:
- a) përcaktimin e politikave tregtare;
  - b) ndryshimin e Statutit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre;
  - d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre;
  - e) mbikyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
  - h) transferimin e kuotave ose pjesë të tyre;
  - i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
  - j) shpërndarjen e fitimeve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të Asamblesë;
  - m) çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky Statut.

Neni 15  
**Regjistri i Vendimeve**

- 15.1 Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, vendimet për:
- i. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ii. Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
  - iii. shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - iv. investimet;
  - v. vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

15.2 Lista e mesiperme nuk është shteruese dhe vendimet e paregjistruara në Regjistrin e Vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 16  
**Administrimi**

16.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të cilët mund të veprojnë bashkërisht ose të veçuar. Afati i emërimit të administratorëve, në rast se nuk është parashikuar ndryshe nga Asambleja, është për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, me të drejtë rinovimi.


16.2 Administrator i parë i Shoqërisë caktohet:

- **Z. Julian Demeti**, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan më 27.07.1981, identifikuar me nr. personal 032675031.

16.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Neni 17  
**Kompetencat e Administratorit/ëve**

17.1 Administratori/ët është/janë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqëson/jnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit ose ligjit të zbatueshëm.

17.2 Administratori/ët ka/në të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që sipas Statutit ose ligjit të zbatueshëm i takojnë Asamblesë së Përgjithshme.

17.3 Administratori/ët ka/në kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

- a) mbikëqyr dhe zbaton politikën e biznesit të Shoqërisë;
- b) përfaqëson Shoqërinë;
- c) kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standartet e mbajtjes së llogarive;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklarim tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;
- f) siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të çertifikuar dhe raporti i llogaritarëve publikë të çertifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
- g) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- h) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare;
- i) kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga ligji ose statuti.

### Neni 18 Eksperti kontabël

18.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.

18.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislati në fuqi.

### Neni 19 Viti financiar dhe bilanci vjetor

19.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

19.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

19.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

19.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

### Neni 20 Fitimet

20.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me vlerën e kuotës së zotëruar.

20.2 Asambleja mund të vendosë zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.



6

Neni 21  
**Prishja**

21.1 Shoqëria priset sipas formave të parashikuara nga Statuti ose ligji. Në rastin e prishjes së Shoqërisë, Asambleja e Ortakeve do zgjedhë një apo më shumë likuidues, duke përcaktuar kompetencat e tyre në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

21.2 Shoqëria mund të ndahet apo bashkohet me shoqëri të tjera sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 22  
**Likuidimi**

22.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.

22.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

22.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

22.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 23  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

23.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

23.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, kompetentepër zgjidhjen do të jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 24  
**Ndryshimet**

24.1 Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose i tëri dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

24.2 Ky Statut është hartuar në katër kopje në gjuhën shqipe, më vlerë të njëjtë secila.

Nënshkruar më 31.05.2021.

\*\*\*

ORTAKET

Rovena Banaca

Rovena BANACA

JULIAN DEMETI

Julian DEMETI

Erald BUZI

